

# Dy vjet pas miratimit të Ligjit të ri për shtetësinë: a është zgjidhur problemi i pashtetësisë?

## Hyrje

Me shpërbërjen e Jugosllavisë dhe me shpalljen e pavarësisë së Maqedonisë së Veriut, më 8 shtator 1991, mijëra qytetarë që jetonin në territorin e vendit e humbën shtetësinë e tyre dhe paisja me shtetësinë së republikës së re u bë shumë i vështirë, e për disa prej tyre edhe mision i pamundur.

Më 3 janar 2020, Maqedonia e Veriut zyrtarisht aderoi në Konventën e vitit 1961 për Reduktimin e Pashtetësisë. Qëllimi i Konventës është të sigurojë shtetësi për të gjithë, si një e drejtë themelore e njeriut, pa diskriminim. Maqedonia e Veriut ishte vendi i fundit nga ish-Jugosllavia që ratifikoi këtë Konventë, më 7 tetor 2019.

Teorikisht, miratimi i Konventës i detyron shtetet palë që të transpozojnë masat mbrojtëse të Konventës në ligjet e tyre të shtetësisë dhe të garantojnë të drejtën e çdo personi për shtetësi. Megjithatë, në praktikë kjo nuk ka ndodhur në Maqedoninë e Veriut dhe u desh një betejë e madhe politike për të siguruar një përparim në adresimin e pashtetësisë.

Në vitin 2021, tri dekada pas shpalljes së pavarësisë, partitë opozitare shqiptare, Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa vendosën në procedurë parlamentare projektligj për ndryshimin e Ligjit për shtetësinë, me synim të zgjidhjes, ndër tjera, të pashtetësisë për shtetasit e ish-Jugosllavisë që kishin jetuar në territorin e Maqedonisë së Veriut deri në shpalljen e pavarësisë.

Pas tensioneve të shumta në Kuvend, të shkaktuara nga opozita maqedonase e cila i kundërshtonte këto ndryshime si antikushtetuese, ndryshimi i Ligjit për shtetësinë kaloi me procedurë të shkurtuar, me flamur evropian, më 29 korrik 2021 dhe u shpall ditën e nesërme.

Neni 7 i Ligjit të ri për shtetësinë e Maqedonisë së Veriut (Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 174/2021 i datës 30 korrik 2021) parasheh marrjen e shtetësisë me automatizëm për shtetasit e ish-Jugosllavisë nëse ata, bashkë me aplikimin e tyre, dorëzojnë një nga 16 dokumentet e përcaktuara me ligj që dëshmojnë se deri në shpalljen e pavarësisë kanë jetuar në territorin e vendit.<sup>1</sup>



## Problemi i pashtetësisë: 20.000 lëndë të bllokuara nga Agjencia për Sigurinë Nacionale?

Një muaj pas marrjes së detyrës, më 15 shkurt 2022, Kryeministri Dimitar Kovaçevski, pas një takimi me ish-kreun e Agjencisë për Sigurinë Nacionale, Viktor Dimovski, në lidhje problemin e pashtetësisë, deklaroi se ishte një *“numër i madh i kërkesave të mbetura në procedurë dhe të trashëguara nga ish Drejtoria për Sigurinë Nacionale, pra rreth 20.000 të tilla”*. Kryeministri arsyetoi lëndët e mbetura në sirtarët e Agjencisë për Sigurinë Nacionale me protokolet e sigurisë që Maqedonia e Veriut duhet t'i zbatojë si vend anëtar i NATO-s, duke thënë se *“verifikimet tani janë më thelbësore sepse neve jemi anëtar i plotëfuqishëm në NATO dhe për këtë arsye procedurat janë më të gjata, përfshirë kritere më të ndjeshme se ato që ishin paraprakisht”*.<sup>ii</sup>

Megjithatë, pas një pyetje drejtuar departamentit për informim të NATO-s nga stafi i Institutit për Politika Publike Arbën Xhaferi, Kryeministri Kovaçevski u demantua brutalisht nga NATO e cila u përgjigj se *“procesi i verifikimeve të sigurisë është një përgjegjësi ekskluzive, sovrane e aleatëve individualë të NATO-s. Ju sugjeroj që për këtë çështje të drejtoheni tek autoritetet e Maqedonisë së Veriut”*.<sup>iii</sup>

Nga kjo, rrjedh se 20.000 aplikime për shtetësi janë mbajtur në sirtarë në mënyrë arbitrare nga Agjencia për Sigurinë Nacionale.

## Sa po zbatohet procedura e nenit 7 të Ligjit të ri për shtetësinë ?

Instituti për Politika Publike Arbën Xhaferi, që nga hyrja në fuqi e ligjit të ri për shtetësinë, në vazhdimësi ka monitoruar zbatimin e tij, duke bashkëpunuar me deputetë në pyetje parlamentare dhe duke dorëzuar kërkesa për qasje në informata me karakter publik tek institucionet përgjegjëse.

Në një pyetje parlamentare të dorëzuar më 7 tetor 2022 nga deputeti Halil Snopçe, Kryeministri Dimitri Kovaçevski ka njoftuar se sipas procedurës së nenit 7 të Ligjit për shtetësi, gjatë periudhës mars 2021 – tetor 2022, janë parashtruar gjithsej 697 kërkesa për marrjen e shtetësisë dhe se:

- 347 persona kanë fituar shtetësinë;
- për 350 persona, procedura për marrjen e shtetësisë ishte në rrjedhë e sipër;
- asnjë aplikues nuk ka marrë përgjigje negative.

Ajo që vihej në pah nga këto numra ishte krijimi i një numri të madh të lëndëve të prapambetura, kryesisht në periudhën e menjëhershme pas miratimit të ligjit të ri për shtetësinë.

Vlen të theksohet se institucionet përgjegjëse në vazhdimësi kanë injoruar pyetjet parlamentare rreth deklaratës së Kryeministrit për 20.000 lëndët e bllokuara nga Agjencia për Sigurinë Nacionale.



Andaj, Instituti për Politika Publike Arbën Xhaferi më 5 qershor 2023, parashtrori dy kërkesa për qasje në informata me karakter publik, drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Agjencisë për Siguri Nacionale.

Këto kërkesa parashtronin tri pyetje të njëjta për të dyja institucionet:

1. A mund të na tregoni për periudhën nga shpallja e pavaresisë së Maqedonisë së Veriut e deri më 30.07.2021, sa është numri i aplikimeve për shtetësi të Maqedonisë së Veriut nga shtetas të ish-RSFJ-së, nga shtetas të republikave tjera të ish-RSFJ-së apo nga njerëz pa shtetësi fare, përfshirë anëtarët e familjeve të tyre?

2. Sa aplikime për shtetësi janë dorëzuar te institucionet përgjegjëse pas shpalljes së Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për shtetësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare Nr 174, 30 korrik 2021), të ventiluara sipas vitit, muajit dhe procedurës së aplikimit?

3. Për cilat arsye janë refuzuar aplikimet e reja për shtetësi të dorëzuara në periudhën pas shpalljes së Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për shtetësi të Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare Nr 174, 30 korrik 2021), të ventiluara sipas shkaqeve të refuzimit?

Agjencia për Sigurinë Nacionale refuzoi të përgjigjet dukë thënë se nuk disponon me informata të këtij lloji, edhe pse ky institucion është kyç në procedurën e dhënies së shtetësisë.

Ministria e Punëve të Brendshme nuk dha përgjigje sipas pyetjeve të parashtruara dhe, për këtë arsye, nuk mund të vlerësohet me saktësi se si ka ndryshuar numri i kërkesave për shtetësi para dhe pas ndryshimit të ligjit për shtetësinë.

Sipas përgjigjes së Ministrisë së Punëve të Brendshme, nga shpallja e ligjit të ri për shtetësinë e deri më 28 qershor 2023:

- 817 persona kanë fituar shtetësinë e Maqedonisë së Veriut, nga të cilët 209 kanë qenë pa shtetësi;
- 198 persona janë në proces të marrjes së shtetësisë, nga të cilët 16 persona janë pa shtetësi.
- Pra, deri në këtë pikë, janë gjithsej 1.015 aplikime për shtetësi sipas procedurës së re të ligjit për shtetësinë, dhe nuk ka patur përgjigje negative.

Instituti për Politika Publike Arbën Xhaferi poashtu ka zbatuar një anketë me 40 persona të cilat i kanë kërkuar konsulencë juridike në lidhje me fitimin e shtetësisë sipas nenit 7 të ligjit për shtetësinë. Sipas kësaj ankete, del se:

- 14 persona e kanë fituar shtetësinë;
- 13 janë në procedurë e sipër;
- 9 persona ende nuk kanë aplikuar;
- një personit i është refuzuar aplikimi me arsyetimin se përbën rrezik për sigurinë e shtetit.



## Konkluzion

Përgjithësisht, procedura për fitimin me automatizëm të shtetësisë për qytetarët pa shtetësi të cilët jetonin në territorin e vendit deri në shpalljen e pavarësisë po funksionon.

Sipas autoriteteve përgjegjëse, nga shpallja e ligjit të ri për shtetësinë e deri më tani, janë dorëzuar mbi 1.000 aplikime, nga të cilat vetëm rreth 200 janë ende në procedurë e sipër. Rreth 800 lëndë kanë marrë epilog dhe kanë përfunduar me fitim të shtetësisë.

Instituti për Politika Publike Arbën Xhaferi megjithatë ka arritur të identifikojë lëndë ku është refuzuar aplikimi nën arsyetimin se personi përbën rrezik për sigurinë e shtetit, gjë që tregon për mostransparencë potenciale nga ana e autoriteteve.

Mostransparenca institucionale ngelet problemi kryesor kur është fjala për çështjen e pashtetësisë, veçanërisht në lidhje me deklaratën e Kryeministrit rreth 20.000 lëndëve që mbahen në mënyrë krejt arbitrare në sirtarët e Agjencisë për Sigurinë Nacionale.

Institucionet përgjegjëse, Agjencia për Siguri Nacionale dhe Ministria e Punëve të Brendshme në veçanti, asnjëherë nuk e kanë mohuar deklaratën e Kryeministrit por as nuk kanë dhënë përgjigje të prerë, duke injoruar këtë çështje në pyetjet e deputetëve apo në kërkesat për qasje në informata me karakter publik.

Nga kjo, rrjedh se ligji i ri për shtetësinë nuk ka siguruar zgjidhje sistemore për çështjen e pashtetësisë.

Andaj, Kuvendi, mediat dhe shoqëria civile duhet të rrisin presionin mbi Agjencinë për Siguri Nacionale dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme për të siguruar transparencë të plotë dhe zbatim të tërësishëm të ligjit sipas dispozitave në fuqi.

### **Instituti për Politika Publike Arbën Xhaferi rekomadon:**

- Ministria e Punëve të Brendshme duhet të sigurojë transparencë të plotë rreth aplikimeve për shtetësi, përfshirë duke u mundësuar aplikuesve që të ndjekin progresin e lëndës së tyre përmes infrastrukturës informatike të ministrisë.
- Ministria e Punëve të Brendshme duhet të trajtojë aplikimet sipas nenit 7 të Ligjit për shtetësinë brenda një afati të arsyeshëm ligjor, me automatizëm dhe pa pengesa e vonesa të pa arsyeshme.
- Komisioni për Mbikëqyrjen e Punës së Agjencisë për Sigurinë Nacionale dhe Agjencisë së Zbulimit duhet të kërkojë raport nga Agjencia për Sigurinë Nacionale rreth 20.000 lëndëve të bllokuara sipas deklaratës së Kryeministrit Kovaçevski, dhe të mbikëqyrë neglizhencat dhe arbitraritetin nga ana e Agjencisë.
- Nëse pengesat nga ana e Agjencisë për Sigurinë Nacionale vazhdojnë, Kuvendi të themelojë komision parlamentar për shtetësinë / natyralizime i cili do të jetë organi i vetëm vendim-marrës në çështjet e shtetësisë, bazuar në praktikat më të mira evropiane.



## Referenca

- 1) certifikatë nga libri amzë i të lindurve;
- 2) dëshmi për mbarimin e vitit shkollor (dëftesë, vërtetim ose diplomë);
- 3) dëshmi për marrëdhënie të themeluar të punës me formular M1/M2;
- 4) librezë pune;
- 5) dëshmi për tatim të paguar në pajtim me rregullativat ligjore, të cilat në atë periudhë kanë qenë në fuqi në Republikën e Maqedonisë, përkatësisht dëshmi se ka paguar: - tatim mbi të ardhurat personale të punëtorëve; - tatim mbi të ardhurat personale për kryerjen e veprimtarisë bujqësore; - tatim mbi të ardhurat personale nga kryerja e pavarur e veprimtarisë ekonomike dhe profesionale; -tatim nga kompensimi nga të drejtat autoriale, patentave dhe avancimeve teknike; -tatim mbi të ardhurat nga prona dhe të drejtat pronësore; - tatim mbi pronën dhe - tatimi mbi trashëgimi dhe dhuratë;
- 6) vendim të obliguesit tatimor nga Drejtoria e të Ardhurave Publike;
- 7) dëshmi për llogari të paguar për shërbimet në vijim: - energji elektrike, - ngrohje, - ujë, -shërbime telefonike;
- 8) dokument udhëtimi (pasaportë) të lëshuar nga ish- RSFJ ose RM;
- 9) letërnjoftim të lëshuar nga ish-RSFJ ose RM;
- 10) letërnjoftim për të huaj;
- 11) librezë shëndetësore;
- 12) raport, vërtetim, fletëlëshim ose dokument tjetër me të cilin dëshmohet mjekimi i bërë në institucione publike shëndetësore në Republikën e Maqedonisë;
- 13) aktzotërim ose aktpronësi në emër të kërkuesit;

14) librezë e kursimit për deponimin e kursimeve në bankë (person juridik) të themeluar nga Republika e Maqedonisë, në pajtim me ligjin;

15) dëshmi tjera të lëshuara nga organet kompetente shtetërore me të cilat do të vërtetohet vendbanimi i përhershëm në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe;

16) dëftesat të cilët janë lëshuar nga viti 1991 deri 1998 për personat e lindur nga viti 1984 deri në vitin 1991.

ii. <https://alsat.mk/shtetesia-kovacevski-takon-kreun-e-ask-se-viktor-dimovski/>

iii. [https://almakos.com/zyrtari-i-nato-demanton-kovacevskin-per-shtetesine-faji-qendron-brenda-institucioneve-te-vendit-dhe-jo-tek-nato/?fbclid=IwAR2DGYhdg7\\_UKIFBOPUoOnFuuwmkcUYLJ0w7N\\_xLXDi7xeqv7wMDDOPPy](https://almakos.com/zyrtari-i-nato-demanton-kovacevskin-per-shtetesine-faji-qendron-brenda-institucioneve-te-vendit-dhe-jo-tek-nato/?fbclid=IwAR2DGYhdg7_UKIFBOPUoOnFuuwmkcUYLJ0w7N_xLXDi7xeqv7wMDDOPPy)

## Kontakt

**Instituti për Politika Publike  
Arbën Xhaferi**

E-mail: [info@ipp-arbenxhaferi.org](mailto:info@ipp-arbenxhaferi.org)

Web: [www.ipp-arbenxhaferi.org](http://www.ipp-arbenxhaferi.org)

Tetovska 7/8/3  
1000 Shkup  
Maqedonia e Veriut

